



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
Komanda e Forcës Ajrore

Nr. 4675 Prot.

Rinas, më 15.12.2023.

MIRATOHET

GJENERAL BRIGADE FERDINANT DIMO

KOMANDANTI I FORCËS AJRORE

DETYRË PROJEKTIMI

**PËR NDËRTIMIN E “KUADRATET KRYESORE DHE DREJTIMET E NGRITJES DHE ULJES, RRUGËT LIDHËSE (TAXIWAY), SHESHET E PARKIMIT TË HELIKOPTERËVE, SI DHE SISTEMI I NDRICIMIT” ME VENDNDODHJE FARKË.**

Për nevojat e Komandaës së Forcës Ajrore dhe Rep. Ush. Nr. 3006, Farkë, dhe bazuar në planin e zhvillimit të Bazës Ajrore Farkë, kërkohet:

Hartimin e projekt-preventivit për ndërtimin e “Kuadratet kryesore dhe drejtimet e ngritjes dhe uljes, rrugët lidhëse (Taxiway), sheshet e parkimit të helikopterëve, si dhe sistemi i ndricimit”, me vendndodhje Farkë, me kërkesat si më poshtë vijon:

- Vënd i ndërtimit në prona nr. 190, Farkë
- Prona nr. 190 “Regjimenti i Helikopterëve” me vendndodhje Farkë
- Kërkohet ndertim i ri, per vitin 2024

**I- Ndërtimi i kuadratet kryesore dhe drejtimet e ngritjes dhe uljes, rrugët lidhëse (Taxiway), sheshet e parkimit të helikopterëve, si dhe sistemi i ndricimit.**

**Kostoja e perafert : 777,860,000 lekë**

**Siperfaqe ndërtimi 174 000 m<sup>2</sup>**

**A- NË DREJTIM TE ANËS NDËRTIMORE**

**A1.Të kryhet ndërtimi i kuadrateve kryesore dhe drejtimet e ngritjes dhe uljes, rrugët lidhëse (Taxiway), sheshet e parkimit të helikopterëve, duke patur në konsideratë se tipi më i madh i helikopterit do të ulet është helikopteri tip Chinook (CH-7) me peshë prej 25000 kg që do jetë edhe pesha kryesore që do merret për bazë për studimin e shtresave. Mënyra e ndërtimit me distancat e sigurisë dhe përmasat e sejcilit kuadrat dhe drejtimi sipas do të jetë sipas “Planit të zhvillimit të infrastrukturës së Bazës Ajrore Farkë”.**

- Permasat e ndertimit të helipadeve kryesore do të jetë  $30 \times 30 = 900 \text{ m}^2$  gjithashtu duhet të shtrohet një shtese prej 7.5 m në të gjitha anët e helipadit për sigurinë kundrejt sendeve dentuese.
- Permasat e drejtimit të ngritjes do të jetë me gjeresi 30 m dhe me gjatesi 285m nga fillimi i helipadit, skema sipas PZHI, Farkë.
- Permasat e drejtimit të uljes do të jetë me gjeresi 30 m dhe me gjatesi 250m nga fillimi i helipadit, skema sipas PZHI, Farkë.
- Largesia e dy helipadeve dhe drejtimeve respektive të tyre do të jetë 80m nga aksi qëndror, skema sipas PZHI, Farkë.
- Taxiway që lidh sheshet e parkimit me drejtimit e uljes dhe ngritjes do të jetë me gjeresi prej 15m, skema sipas PZHI, Farkë.
- Përmasat e pjacolave të parkimit të helikopterëve do të jenë sipas skemës së PZHI, Farkë.

A2- Shtrimi i shesheve dhe rrugëve lidhëse të bëhet me shtrese betoni i forcuar me rrjete metalike të elektrosalduar, sheshet me përmasa mbi  $30 \times 30$  të bëhen me finiture sipërfaqesore e tipit Aeroportuale e kufizuar nga prerje terthore kundër carjes .

- Helipadet e parkimit të jenë me hidroizolim të lartë me veti jo percjellese ndaj elektricitetit e qëndrueshme nga vajrat e karburanteve.
- Lyerje me llak special. Qëndrueshmëria e Helipadeve të parkimit duhet të jenë rezistente ndaj peshes së helikopterit bashkë me paisjet dhe ekupazhin.
- Në zonën e ulje ngritjeve të vendoset një indikator të drejtimit të eres. Ky indikator duhet të jetë i përdorshëm edhe për natën (fluorishent).

A3- Sistemi i ndricimit të drejtimit të uljes dhe ngritjes duhet të përbehet nga tre lloje:

1. Interval në një distancë prej 30 m
2. Ato të perimetrit me distancë prej 90 m
3. Dritat e afrimit me distancë prej 210 m

A4- Instalimet për mbrojtje atmosferike (togezim).

A5- Të parashikohet një dranzhim i lartë.

## **B-NE DREJTIM TE INSTALIMEVE**

**B1-** Sistemi i ndricimit të jete i lartë, të parashikohet linja trefazore si dhe : Ndricim FATO dhe TLOF

Sinjalizimi i zonës TLOF, bëhet me vijëzim përgjatë gjithë perimetrit të saj me ngjyrë të bardhë dhe me trashësi të vijës 30 cm. Gjithashtu në zonën e TLOF duhet të shënohet (me ngjyrë të bardhë) edhe masa e lejuar në ton (t), diametrin e zonës si dhe përmasat e saj ( gjeresi x gjatësi) Vendosja e dritave në zonën e TLOF duhet të bëhet në një distancë jo më pak se 3 m nga njëra tjetra dhe në çdo cep të perimetrit të saj me të paktën katër sinjale ndricimi me ngjyrë jeshile në çdo anë.

Dritat në zonën FATO do të vendosen në çdo anë dhe jo më pak se 4 copë. Kjo zonë do ketë një pjerrësi prej 5% në të gjitha anët e saj.

Përsa i përket zonës së sigurisë duhet një largësi të paktën prej 9.35 nga zona FATO. Gjithashtu zona e sigurisë duhet të jetë e sinjalizuar me vijë të bardhë të ndërprerë. Sistemi i ndricimit të afrimit është i përbërë nga një sistem dritash me largësi prej 30 m, si dhe sistemi i dritave të vendosura në mënyrë tërthore në një gjatësi prej 18 m dhe në një largësi prej 4.5 m larg njëra tjetrës

Përsa i përket komandimit të sistemit të ndricimit të bëhet nga kulla e kontrollit por të shihet dhe mundësia për një sistem komandimi të pavarur nga gabina që do furnizojë këtë zonë me energji.

#### **Dritat treguesve te eres.**

Në kulmin më të lartë të treguesit të erës duhet të vendoset ndricues i përcakton edhe lartësinë maksimale të treguesit të erës, pasi është pengesë ajrore.

Dritat e identifikimit te Helikopterit.

Dritat e drejtimit te uljes

Dritat e drejtimit të ngritjes

Ndricimi me prozektore.

Dritat e Taxiway-it.

Te parashikohet vendosja e dritave te pengesave ne objektet ne lartesi. (Stanag 3346 "Marking and Lighting of Airfield Obstructions")

#### **C-NE DREJTIM TE INFRASTRUKTURES.**

**C1-** Sinjalizimi i zonës TLOF bëhet me vijëzim përgjatë gjithë perimetrit të saj me ngjyrë të bardhë dhe me trashësi të vijës 30 cm. Gjithashtu në zonën e TLOF duhet të shënohet (me ngjyrë të bardhë) edhe masa e lejuar në ton (t), diametrin e zonës si dhe përmasat e saj ( gjerësi x gjatësi).

Përsa i përket pjerrësisë nuk duhet të tejkalohet 1 % përgjatë gjatësisë së "Vijës së Uljes", ndërsa për pjerrësinë tërthore duhet të kihet parasysh minimum 1% dhe maximumi 1.5% .

**C2-** Pika e marrjes se energjise elektrike do të jetë kabina elektrike në afërsi të fushës së sportit, të Bazës Ajrore, Farke.

**C3-** Të bëhet sistemi i mbledhjes dhe shkarkimit të ujrave të shirave dhe ujrave që vijnë nga shpati i malit i perbere nga nje numer i mjaftueshem pusetash mbledhese, te lidhura nepermjet tombinove me derdhjen e tyre në peroin e njësisë administrative, Farkë. Gjithashtu kërkohet azhurnim ne terren nga projektuesit për të parë mundësinë e shfrytëzimit të rrejtit aktual .

**PERGATITI**

**N/Kolonel Pëllumb SEVDARI**

**N/Kolonel Miri JERA**

**Major Sokol HASIMLLARI**